



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELIDA TAKE
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE
NR. 5, RR. TISH DAIJA, GODINA NR.
9, NJESIA 1, HYRJA 1
TEL: 0698885621

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 647

Nr. koleksioni: 429

Tirane më 23/06/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2025053770045993407

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 647 REP

NR. 429. KOL

KONTRATË SHITBLERJE
KUOTASH KAPITALI

Sot më datë 23.06.2025 (dymijë e njëzet e pesë), para meje noterit publik, Elida H.TAKE, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale të ndodhur në rr."Tish Daija" Tirane, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë Egian by Intermedica Sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse:

Shoqëria Intermedica Center shpk, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me datë 13.03.2003, me Nipt K31513084W me qendër në Tiranë, në adresën Rruga Jordan Misja, (referuar ekstrakt të QKB) shoqëri e cila paraqitet në këtë kontratë në cilësinë e ortakut zotërues 45% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë Egian by Intermedica shpk - përfaqësuar nga ortaku i vetëm **z. Vasil LLAJO**, shtetas shqiptar, atesia Spiro, amesia Polikseni, lindur me 24.11.1956, ne Sarande e banues ne Tirane (sipas deklarimit të tij), madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit biometrik me nr. personal F61124009B - zotërues 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "INTERMEDICA CENTER" shpk.

Pala Blerëse:

Z.Fatos Mollosmani, i datëlindjes 25.09.1970, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, në adresën Tirane, (sipas deklarimit të tij), madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me numër personal H00925053L.

Kushtet Paraprake

- Shoqëria Egian by intermedica shpk, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) me Certifikatë Regjistrimi (NIPT) M22016024G, me zyrë qendrore në Tiranë me kapital të regjistruar 10,000 (dhjetë mijë) lekë; me ortakë Shoqëria Intermedica Center shpk zotërues i 1 (një) kuote, e cila përbën 45% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe z Fatos Mollosmani zotërues i 55% të kapitalit të shoqërisë; me administratore z Fatos Mollosmani.
- Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën që ai zotëron në shoqërisë Egian by Intermedica Shpk dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI



2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse Shoqëria Intermedica Center shpk i shet palës blerëse dhe konkterisht z Fatos Mollosmani, 1 kuotë = 45% të kapitalit që zotëron në shoqërinë Egian by Intermedica Shpk.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ortak i vetëm i shoqërisë Egian by Intermedica Shpk do të jetë z Fatos Mollosmani zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë Egian by Intermedica Shpk

III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës, objekt i kësaj kontrate, është 4 500 (katërmije e pesëqind) lekë. Çmimi i kontratës do të likuidohet nga pala blerëse në masën 4 500 (katërmije e pesëqind) lekë nga Fatos Mollosmani direkt në llogarinë bankare të komunikuar nga pala shitëse Shoqëria Intermedica Center shpk, brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

3.2 Për çdo vonesë në pagesën e çmimit, do të aplikohet një interes në masën 10% në vit.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj ka/në të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar e teknik të shoqërisë Egian by Intermedica Shpk.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj kontrate.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe z Fatos Mollosmani do të bëhet ortak i vetëm i shoqërisë Egian by Intermedica shpk, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Nga momenti i regjistrimit të kësaj kontrate në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën që ai ka në shoqërinë Egian by Intermedica shpk

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë palëve nga unë noteri publik, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noteri e vërtetoj atë në bazë të ligjit.

Ne zbatim të ligjit nr.9887, date 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", une noterja deklaroj se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjektit te ketij akti, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

PALA SHITËSE

Shoqëria Intermedica Center shpk
Ortaku i vetëm z. Vasil LLAJO

PALA BLERËSE

Fatos MOLLOSMANI

NOTER

Elida H. TAKE

INTERMEDICA CENTER SHPK
RR. JORDAN MISJA, TIRANË
NIPT: K 31513084 W
Tel: 22200600 FAX: 2234166

Elida H. Take